

**NJOFTIM**  
**Nr. 83/2, datë 15.1.2024**

**PËR SHPALLJEN E 1 (NJË) VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E  
KËSHILLTARIT EKONOMIK, ME AFAT TË CAKTUAR, NË KOMISIONIN E  
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ekonomik, me afat të caktuar, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3,

**Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:**

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi, me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri, ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematike osenë drejtësi, jashtë vendit dhe të jetë e njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sektorin financiar.

**Kushte të përgjithshme:**

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

**Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:**

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuara));

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen **brenda datës 28.1.2024**, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën; Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [info@kpk.al](mailto:info@kpk.al), i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.